

L I G J
Nr.7800, datë 2.3.1994

**PËR PAGAT E GJYQTARËVE, NDIHMËSGJYQTARËVE EFEKTIVË, PROKURORËVE
DHE HETUESVE**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, dhe të nenit 30 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

Neni 1

Paga e gjyqtarëve, ndihmësgjyqtarëve efektivë, prokurorëve dhe hetuesve të jenë sipas pasqyrave që i bashkëngjiten këtij ligji.

Neni 2

Gjyqtarët dhe prokurorët ushtarakë përfitojnë shtesën për gradat ushtarake.

Neni 3

Prokurorët dhe hetuesit civilë të rretheve trajtohen me normë veshmbathjeje sipas pasqyrës që i bashkëngjitet këtij ligji.

Neni 4

Kategoritë e personave të përmendur në këtë ligj përfitojnë të drejtën e kompensimeve njëloj si punonjësit e tjerë të institucioneve buxhetore. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të bëjë indeksimin e pagave për personat e përmendur në këtë ligj sa herë që do të bëhen ndryshime në pagë për punëmarrësit në institucionet buxhetore.

Neni 5

Ligji nr.7668, datë 2.2.1993 “Për pagat e gjyqtarëve, të prokurorëve dhe hetuesve” dhe ligji nr.7669, datë 2.2.1993 “Për pagat e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese”, shfuqizohen.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë dhe efektet e tij shtrihen nga data 16 janar 1994.

Shpallur me dekretin nr.794, datë 8.3.1994 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.

PASQYRA NR.1
PAGA MUJORE E ANËTARËVE TË GJYKATËS KUSHTETESE

1. Kryetar	20 000
2. Anëtar	17 000

PASQYRA NR.2
PAGA MUJORE E ANËTARËVE TË GJYKATËS SË KASACIONIT

1. Kryetar	20 000
2. Zëvendëskryetar.....	18 000
3. Anëtar.....	17 000

PASQYRA NR.3
PAGAT MUJORE TË PUNONJËSVE TË PROKURORIVE

Prokuroria e Përgjithshme	
1. Prokuror i Përgjithshëm	19 600
2. Zv.prokuror i Përgjithshëm.....	17 000
3. Prokuror i Gjykatës së Kasacionit	16 500
4. Prokuror (drejtor drejtorie).....	15 500
5. Prokuror dhe hetues në Prokurorinë e Përgjithshme.....	15 000

Prokuroria e Apelit Civil në Tiranë	
1. Prokuror rrethi	15 500
2. Zëvendësprokuror.....	15 000
3. Prokuror.....	14 000

88

Prokuroritë e apelit civil dhe ushtarak të rretheve
dhe prokuroria e rrethit të Tiranës

1. Prokuror rrethi	15 000
2. Zëvendësprokuror.....	14 000
3. Prokuror.....	13 000
4. Hetues.....	12 000

Prokuroritë e rretheve të kategorisë I dhe II

1. Prokuror rrethi.....	14 000
2. Zëvendësprokuror.....	13 000
3. Prokuror.....	12 000
4. Hetues.....	11 400

PASQYRA NR.4
PAGA MUJORE E GJYQTARËVE DHE E NDIHMËSGJYQTARËVE

Gjykata e apelit civil Tiranë

1. Kryetar.....	16 400
2. Zëvendëskryetar.....	15 300
3. Gjyqtar.....	14 300

Gjykatat e apelit civil dhe ushtarak në rrethe
dhe gjykata e rrethit të Tiranës

1. Kryetar.....	15 300
2. Zëvendëskryetar.....	14 300
3. Gjyqtar.....	13 200

Gjykata e rretheve të kategorisë I dhe II

1. Kryetar.....14 300
2. Zëvendëskryetar.....13 200
3. Gjyqtar..... 12 400

Ndihmësgjyqtarë efektivë pranë gjykatave të rretheve

Ndihmësgjyqtar.....11 200

89

PASQYRA NR.5

NORMA E TRAJTIMIT NË VESHMBATHJE TË PROKURORËVE E HETUESVE TË RRETHEVE

- | | | |
|------------|--------------|---------------|
| 1. Këpucë | palë 1 (një) | në vit |
| 2. Këmishë | “ 1 (një) | në vit |
| 3. Pardesy | “ 1 (një) | në katër vjet |
| 4. Pallto | “ 1 (një) | në pesë vjet |
| 5. Kostum | “ 1 (një) | në katër vjet |